



**UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANË**

**UNIVERSITETI I PEJËS
"HAXHI ZEKA"**

Nr. prot. 1627, Datë 21. 11. 2024

Nr. prot. 3046, Datë 22. 11. 2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**UNIVERSITETIT TË ARTEVE (UART) DHE UNIVERSITETIT TË PEJËS "HAXHI
ZEKA" (UHZ)**

Sot në Pejë, më datë 22.11.2024, *më qëllim që*, në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës, të nxitet dhe të zhvillohet më tej, arti, shkenca, të formohen specialistë të lartë dhe të përgatiten artistë dhe shkencëtarë të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendeve; të ofrohen mundësi të barabarta për të përfutur nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; të integrohet mësimdhënia me kërkimin shkencor; të nxitet bashkëpunimi dhe ndërkombëtarizimi në fushën e arsimit të lartë, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet palëve:

Universitetit të Arteve të Tiranës, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Erald Bakalli

Dhe

Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka”, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Armand Krasniqi

Neni 1

Objekti

1. Palët, për realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshje, shprehin gatishmërinë për të bashkëpunuar për hartimin, aplikimin dhe/ose zbatimin e projekteve të përbashkëta, si edhe për zhvillimin e çdo lloj veprimtarie apo aktiviteti tjetër të nevojshëm.
2. Universiteti i Arteve dhe Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”, në zbatim të pikës 1, të nenit 1, të kësaj Marrëveshjeje, kryesisht do të:
 - a. bashkëpunojnë për hartimin dhe aplikimin në projekte kombëtare, mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare, kryesisht të financuara nga BE, si: Erasmus +, Horizon 2020 etj., për të cilat do të kërkohet përfshirja e stafit akademik, stafit drejtues dhe studentëve, të palëve në zbatim të këtyre projekteve;
 - b. bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta artistike, debate, konferenca, simpoziume, workshop-e, shkolla verore dhe dimërore, në fusha të ndryshme të artit dhe kulturës, etj.;
 - c. bashkëpunojnë për ngritjen e komisioneve/ jurive/ grupeve të përbashkëta të punës për të vlerësuar standardet dhe kriteret e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi për zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit artistik shkencor, etj., për dhënien e gradave dhe titujve akademikë;
 - d. bashkëpunojnë për lehtësimin e procedurave të transferimit të studentëve ndërmjet universiteteve;
 - e. bashkëpunojnë për lejimin e shkëmbimeve afatshkurtra të stafit akademik/ndihmës akademik dhe studentëve;

- f. bashkëpunojnë për shkëmbimin dhe përdorimin e literaturës (partiturave) artistike shkencore dhe platformave online, etj.;
 - g. bashkëpunojnë për nxitjen dhe mbështetjen e projekteve artistike-kërkimore-shkencore në fushat e artit dhe kulturës me interes të përbashkët, etj.
3. Palët, me qëllim përmbushjen me sukses të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, do të diskutojnë paraprakisht mbi mënyrën dhe organizimin e veprimtarive të parashikuara në pikën 2, të nenit 1, të kësaj Marrëveshjeje, si edhe të bashkëpunimeve, projekteve apo aktiviteteve të tjera të përbashkëta.
 4. Me qëllim të planifikimit dhe realizimit të veprimeve si në paragrafin 2 të Nenit 1, palët bien dakord si më poshtë:
 - a. Duke filluar nga viti akademik 2024-2025 stafet akademike mund të ofrojnë cikle të leksioneve/ligjëratave/mësime në lëndët speciale në kurset e akredituara të Fakulteteve përkatëse.
 - b. Të bashkëpunojnë në qartësimin e procedurave të transferimit dhe qëndrimit të studentëve në Universitetin përkatës dhe mënyrën e transferimit të kredive ECTS.

Neni 2

Financimi

1. Palët, brenda buxhetit të tyre të miratuar, do të parashikojnë fonde me qëllim që të mbulohen tërësisht ose pjesërisht shpenzimet e nevojshme, për të mundësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
2. Palët, së bashku ose veç e veç, mund të kërkojnë financime të jashtme për të mundësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Përdorimi i informacionit dhe dokumentacionit

1. Palët bien dakord që informacionet, dokumentet apo të dhënat e shkëmbyera apo të pranuar sipas kësaj Marrëveshjeje, do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të saj.
2. Palët, pa aprovim paraprak me shkrim të palës tjetër, nuk mund të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhënë tjetër të njëri-tjetrit, përveç se për të realizuar qëllimin e përcaktuar, apo që nuk bien ndesh në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Të drejtat e Pronësisë intelektuale

Të gjitha marrëveshjet që kanë lidhje me të drejtat intelektuale aktuale dhe të ardhshme të fituara nga secila palë, si pasojë e zhvillimi të një aktiviteti të përbashkët sipas nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje, duhet të rregullohen nga një shtesë/ marrëveshjeje e veçantë që do t'i lidhet kësaj marrëveshjeje dhe do të jetë pjesë integrale e saj.

Neni 5

Njoftimet

1. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet që realizohen në kuadër të Marrëveshjes, bëhen me shkrim dhe dërgohen në adresën e mëposhtme, ose në adresa të tjera, të përcaktuara nga palët herë pas here. Njoftimet do të dërgohen elektronikisht, ose përmes shërbimit postar të çertifikuar, ku të gjitha pagesat dhe tarifat postare parapaguhën nga pala që dërgon njoftimin me shkrim.
2. Në përgjithësi, njoftimet drejtohen në adresat e mëposhtme:

Për Universitetin e Arteve:

Universiteti i Arteve
Sheshi "Nënë Tereza"
Nr. 2
Tiranë, Shqipëri

Për Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë:

Rr. "UÇK"-së,
30000 Pejë
Republika e Kosovës

Neni 6

Rektorët, apo përfaqësues të tyre, do të takohen të paktën 1 (një) herë në vit, kryesisht në fillim të çdo viti akademik, me qëllim diskutimin për krijimin e kushteve dhe mundësive për realizimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 7

Të gjitha ndryshimet e kësaj marrëveshjeje, që të quhen të vlefshme, duhet të bëhen me shkrim, në të kundërt konsiderohen të pavlefshme.

Neni 8
Dispozitat e fundit

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga të dyja palët dhe është e vlefshme për një periudhë katërvjeçare. Me kalimin e këtij afati, nëse palët nuk kërkojnë me shkrim heqjen dorë nga kjo marrëveshje, ajo rinovohet në mënyrë të heshtur.
2. Palët mund të kërkojnë tërheqjen nga kjo marrëveshje në çdo kohë duke bërë një njoftim me shkrim të paktën dy muaj para, si edhe duke parashtruar arsyet e tërheqjes.
3. Palët, në rast se lindin mosmarrëveshje gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, marrin përsipër zgjidhjen e tyre me mirëkuptim.
4. Kjo Marrëveshje përpilohet në 4 (katër) kopje identike në gjuhën shqipe dhe secila palë merr nga dy kopje.

PALËT NËNSHKRUESE


UNIVERSITETI I ARTEVE



REKTOR

Prof. Dr. ERALD BAKALLI

UNIVERSITETI I PEJËS
“HAXI ZEKA”



REKTOR

Prof. Dr. ARMAND KRASNIQI